



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF
SUHAREKA

18-04-2025

| | | | |
|---|-------------------------|-------------------------------|----------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E SUHAREKËS MUNICIPALITY OF SUHAREKA | | | |
| NË DORËZIM-PRILJENO-RECEIVED | | | |
| Njësia org. Org. Jerinica Org. Unit | Numri Broj Number | Shtojca Prilog Appendix | Vlera Vrednost Value |
| 01 | 06 | 23021 | |


| | | |
|--------|--|------------------|
| 11 Nr. | Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër | Data: 18.04.2025 |
|--------|--|------------------|

| | |
|---------------|---|
| Për: | Kryetarin e Komunës z. Bali MUHARREMAJ |
| Nga: | Drejtoria e Shërbimeve Pronësore-Juridike dhe Kadastër |
| Lënda: | Njoftim |

Më anë të kësaj shkrese ju njoftojmë se Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër, bazuar në kërkesën e zyrës së Kryetarit ka përgaditur materialin për inicim në Asamblen Komunale për dhënien në shfrytëim të pronës Komunale.

- Të dhënat kadastrale për parcelen 04491-0 me sipërfaqe të përgjithshme 162579m² ZK Bllacë.
- Nga sipërfaqja e përgjithshme propozimi për dhënie në shfrytëzim është për pjesën e parcelës me sipërfaqe prej 60000 m²
- Dëshmi: Certifikata e pronës, Skica ideore dhe Kopja e planit
- **Qëllimi:** “veprimtari bisnisore- Gurthues”.
- Përshkrimi i DUP.
- Kerkesa e palës (licenca e shfrytëzimit, pelqim nga komuna ne vitin 2010, pelqim elektroenergetik).
- **Arsyja:** Përfitimi ekonomik i Komunës.

Bazuar në këtë ju rekomandojm që nëse konsideroni se ka arsyeshmëri të interes publik apo përfitimit ekonomik të komunës , lëndën e procedojme tek ju (si organ kompetent), për zhvillim të procedurave konform **Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës Ligji Nr. 06/L-092.**

D.SH.PJ.K Armend Krasniqi 



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72116003-04491-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

1742/2025

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

18.04.2025 - 14:42

Komuna / Opština / Municipality:

SUHAREKË / SUVA REKA / SUHAREKË

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Bllacë / Blacë

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:


SUHAREKË / SUVA REKA / SUHAREKË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area (m ²) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Urađeno na dan Created On | Azhuruar Azurirano Updated |
|---|--|---|---------------------------|---|----------------------------------|--|----------------------------------|
| P-72116003-04491-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land | | 162579 | | | |

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur Mesto zvano Called place | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Emri i rrugës Naziv ulice/ULICE Street name | Krijuar më datën Urađeno na dan Created On | Azhuruar Azurirano Updated |
|--|---|---|--|----------------------------------|
| GALUSHA/BIRAQ | | | | |



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri Broj Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use | Kualiteti i klasës Kvalitet Klasse Quality Class | Sipërfaqja Površina Area (m ²) (m ²) |
|-------------------------|--|--|--|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosar/Pashnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 6/Pasnjak 6 Klasse/6th Class Pasture | 162579 |

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat Prava Rights | Emri Ime Name | Nr. personal Liceni broj ID. No. | Vendbanimi Prebivaliste Resident | Kodi postal Poštanski kod Postal code | Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Pershkrimi Opis Description | Azhuruar Azurirano Updated |
|---|---------------------|--|--|---|---|--|-----------------------------------|----------------------------------|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | Komuna e Suharekës | 600535209 | / / / | | BRIGADA 123 | 1/1 | | |

PASHTRIKU

sh.p.k

Institucioni : KOMUNA SUHAREKË

- ZYRA E KRYETARIT

DREJTORIA PRONË DHE KADASTËR

KËRKESË

Lënda : Kërkesë për Kontratë

Parashtruesi i kërkesës: " PASHTRIKU " shpk

Nr. Biznesit 811035577

| REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA | | | |
|---|--------------------------|-----------------------|-------------------------------|
| MARRË NË DORËZIM PRIMLJENO RECEIVED | | | |
| Njësia e g. Org. jed. Org. unit | Numri Brej. Number | Data Datum Date | Shtojca Prilog Appendix |
| | 11-463-66448 | | 0.50 |

Kërkojmë nga titulli i lartëshënuar, gjegjësishtë nga **Zyra e Kryetarit** që të na mundësojë dhënjën në shfrytëzim me qera afat shkurtër të pronës Kadastrale ngastra P-72116003-04491-0 në vendin e quajtur **GALLUSHA** në Fshatin **BLLACË**.

Pasi që ne jemi të paisur me **PELQIM** nga Komuna e Suharekës të datës 30.03.2010 ne numer të PELQIMIT 07-Nr -74 dhe kemi

LICENCË nga **KPMM**-ja me nr. të Licencës 2076/KPMM/2020 të datës 15.05.2020 dhe me kohëzgjatje deri 11.09.2031. dhe

LEJE MJEDISORE nga **Ministria e Ambientit**, nr. Protokolit 21/4513/MMPHI të datës 06.09.2022 dhe

PELQIMIN DHE LEJE NDËRTIMORE PËR NDËRTIM TË RRJETIT ELEKTRIK DHE VENDOSJE TË TRAFOS 10(20)/0.4kv nga Komuna e Suharekës të datës 03.10.2022

Kërkojme nga ju që të paisemi me **KONTRATË** të qiradhënjes për Qira.

Data: 03.10.2024

Parashtruesi i kërkesës:

" PASHTRIKU " shpk





REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
 Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
 Independent Commission for Mines and Minerals



Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) në pajtim me nenin 6, 31, 33, 59 dhe 62 të Ligjit për Minierat dhe Minalet nr. 03/L-163 si dhe Ligjin nr. 04/L-158 Për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet, në mbledhjen e mbajtur me datën 21/06/2019, lëshon këtë:

Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale (NCRM) u skladu s članom 6, 31, 33, 59 i 62 Zakona o Rudnicima i Mineralima br. 03/L-163 kao i Zakona br. 04/L-158 za Promene i Dopune Zakona br. 03/L-163 za Rudnike i Minerale, na održanoj sednici sa datumom 21/06/2019, izdaje ovo:


Independent Commission for Mines and Minerals (ICMM) in accordance with article 6, 31, 33, 59 and 62 of the Law on Mines and Minerals no. 03/L-163 and the Law no. 04/L-158 on Amending and Supplementing the Law no. 03/L-163 on Mines and Minerals, in the meeting held on 21/06/2019, hereby issues this:

LICENCË SHFRYTËZIMI
RUDARSKA LICENCA / MINING LICENSE
 2076/KPMM/2020

| | |
|--|--|
| Emri i Biznesit / Naziv Biznisa / Name of Business: | Pashtriku SH.P.K |
| Nr. i Biznesit / Br. Biznisa / Business No: | 811035577 |
| Nr. i Regjistrimit / Br. Registracije / Registration No: | 2651 |
| Pronar i Biznesit / Vlasnik Biznisa / Business Owner: | Ditjon Bajraktari |
| Kohëzgjatja / Trajanje / Duration: 11/09/2031 | Sipërfaqja / Površina / Surface area: 50048 m ² |
| Emri i vendit / Ime mesta / Site name: Bllacë | Grupa minerale / Mineralna grupa / Commodity group: |
| Komuna / Opština / Municipality: Suharekë | Shkëmb i fortë / cvrsti kamen / hard rock |

Të drejtat dhe detyrimet / Prava i obaveze / Rights and obligations:

- Kompania e licencuar obligohet që t'iu përmbahet kushteve të kësaj licençe dhe obligohet të përmbush detyrimet sipas nenit 34 të Ligjit për Minierat dhe Minalet nr. 03/L-163 si dhe me Ligjin nr. 04/L-158 Për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet
- Licencirana kompanija je dužna da se pridržava uslova ove licençe i zadužuje se da ispuni svoje obaveze iz člana 34 Zakona o Rudnicima i Mineralima br. 03/L-163 kao i Zakona br. 04/L-158 za Promene i Dopune Zakona br. 03/L-163 za Rudnike i Minerale
- Licensed company is obliged to comply with the terms of this license and is obliged to fulfil its obligations under article 34 of the Law on Mines and Minerals no. 03/L-163 and the Law no. 04/L-158 on Amending and Supplementing the Law no. 03/L-163 on Mines and Minerals.



Drejtori / Direktor / Director

Ramiz KRASNIQI

[Signature]
 PRISHTINE/A

Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No: 1696

Datë / Datum / Date: 15.05.2020



KRYETARI I KOMUNËS

01- Nr-497

Më datë 30.03.2010

Për : Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Prishtinë
Drejtorin e Minerave dhe Mineraleve – Prishtinë

Kopje : Riza Zekolli nga fshati Bllacë

Nga : Kryetari i Komunës në Suharekë

Lënda : Pëlqim për vazhdimin e procedurës në organet kompetente.

Në bazë të raportit të komisionit të formuar nga Kryetari i Komunës, raportit numër 07-Nr-74 të datës 22.03.2010, Kryetari i Komunës lëshon këtë :

Pëlqim për vazhdimin e procedurës së licencimit në organet kompetente në Prishtinë, për thyerje dhe eksplotim (shfrytëzim) i gurit në vendin e quajtur “Gallush” në fshatin Bllacë.

Pëlqimi lëshohet për parcelat 4491, fleta poseduese nr-352 në vendin e quajtur “Gallush” - kullos e klasit të 6 (gjashtë) në sipërfaqe prej 6.00 ha zona kadastrale Bllacë, pasuri shoqërore e KK Suharekë p. p 1/1 .

Nëse personi i lartshënuar në afatin prej 3 muaj nga data e lëshimit të pëlqimit nuk fillon procedurat e licencimit në organet kompetente në Prishtinë, atëherë pëlqimi është i pa vlershëm.



Me respekt

Kopje:
Palës
Arkiva



Kryetari i Komunës

Blerim Kuçi

| | | |
|---|--|---|
|  | REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË |  |
|---|--|---|

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 03.10.2022

Numri i vrojtimit të lejes:

07 Nr.643/350-60743

-Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës, në bazë të kërkesës së z. Ditjon Bajraktari - drejtor i firmës "Pashtriku"Shpk. nga Bllaca, Komuna Suharekë, me 07Nr.350-60743 të datës 19.09.2022, në bazë të nenit 2 paragrafi 1 pika 11 si dhe neni 25 deri 28 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184 të datës 07.10.2010, nenit 5, 14 dhe 21 të Ligjit të ndërtimit Nr.04/L-110 dt.31 Maj 2012, nenit 3, 31, 36 dhe 42 të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve 01Nr.-16-423 dt. 26.01.2011, nenit 21 të Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor-Nr.04/L-174 dt. 31.07.2013, nenit 27 të Ligjit për rrugët Nr. 2003/11, nenit 14, 17, 34, 35, 62, 107, 112, 113 dhe 114 të Vendimit për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe shërbimeve komunale në territorin e komunës së Suharekës 01Nr.109/2001 dt. 16.03.2001 dhe nenit 44, 47, 48 e 125 të LPA-së bie këtë :

PËLQIM

| Ky dokument lëshohet për: | | | |
|---------------------------|--|---------------|--|
| Emri: | Ditjon Bajraktari -"Pashtriku"Shpk. Bllacë, Komuna Suharekë. | Nr. Personal | 2173743877 |
| Adresa: | Rr."Zekë Bajraktari"-Suharekë. | Telefoni: | 043/776-700 |
| Email : | | Kërkesa Bazë: | Pëlqim - leje ndërtimore për ndërtim të rrjetit elektrik dhe vendosje të trafos 10(20)/0.4 kV në fshatin Bllacë. |

Përshkrimi:

I LEJOHET - investuesit - **z. Ditjon Bajraktari** - drejtor i firmës "Pashtriku"Shpk. nga Bllaca, Komuna Suharekë, me 07Nr.350-60743 të datës 19.09.2022 – kryerja e punimeve ndërtimore për ndërtim të rrjetit elektrik ; - realizim të kyçjes, ndërtimit të rrjetit elektrik ajror të tensionit të ulët me shtylla të betonit me kabllo Al/Çe 6x4mm² dhe nëntokësor me kabllo PPOO-A 3x4mm², ndërtim të trafostacionit të ri TS 10(20)/0.4 kV me fuqi Sn=400kVA - sipas "Pëlqimit Elektroenergjetik-Vazhdim Afati" të dhënë nga KEDS-Prishtinë me Nr.8510 të datës 19.08.2022 - të tipit "Blindë Metalike ose murosor" me të gjitha pajisjet adekuate për këtë tip të trafostacionit. Trafostacioni i ri TS 10(20)/0.4 kV me fuqi Sn=400kVA të tipit "Blindë metalike" do të ndërtohet në parcelën kadastrale Nr.04491-0 – pronë shoqërore, vendi i quajtur "Biraç", zona kadastrale Bllacë.

Punimet të punohen sipas projektit ideor, përshkrimit teknik të dorëzuar së bashku me kërkesën 07 Nr. 350-60743 të datës 19.09.2022 dhe **zgjidhjes teknike - "Pëlqimit Elektroenergjetik - Vazhdim Afati" Nr.8510 të dt. 19.08.2022** të dhënë nga KEDS-i Prishtinë.

Gjatësia e ndërtimit të rrjetit elektrik ajror është **L= 1.900m`**.

Vendosja përkatësisht ndërtimi i rrjetit elektrik ajror - LP 10(kV) me shtylla të betonit për TU të vendosen në vendet - pozitat sipas specifikimit teknik.

Furnizimi i objektit me energji elektrike (kyçja) do të bëhet sipas zgjidhjes teknike të dhënë nga KEDS-i. Prishtinë me **"Pëlqimin Elektroenergjetik-vazhdim i afatit" - Nr.8510 të dt. 19.08.2022.**

Vendosja apo ndërtimi i ormanit shpërndarës (KSHE), të bëhet nga organi kompetent përkatës i profesionalizuar për kryerjen e veprimtarisë së tillë.

Vendosja përkatësisht ndërtimi i trafos TS 10(20)/0,4 kV me fuqi Sn=400 kVA të tipit "Blindë Metalike ose murosor" me të gjitha pajisjet adekuate për këtë tip të trafostacionit, të bëhet nga organi kompetent përkatës i profesionalizuar për kryerjen e veprimtarisë së tillë.

Objekti i përkohshëm - trafostacioni të vendoset duke respektuar ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe vendosja të bëhet duke u larguar minimum **10.00 m** nga rrugët dhe parcelat fqinje.

Të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Pëlqimin Elektroenergjetik dhe zgjidhjen teknike të dhënë nga KEDS-i - Prishtinë të respektohen në përpikmëri.

Çdo problem pronaro - juridik që mund të paraqitet për realizimin e projektit në fjalë e që mund të cenojë pronat private, hyrjet etj. duhet të përgjigjet investitori dhe KEDS-i dhe ti zgjidhë vet problemet eventuale që mund të lindin në këto raste.

Gjatë kryerjes së punimeve punë kryesi vendin ndërtimor duhet patjetër ta siguroj në mënyrë të volitshme, në pajtim me dispozitat e mbrojtjes në punë - sipas nenit 114 të Vendimit për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe shërbimeve komunale në territorin e komunës së Therandës - 01 Nr. 109/2001 të datës 16.03.2001.

Punimet duhet të kryhen në atë mënyrë që të mos e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Punimet duhet të kryhen në atë mënyrë që të mos e pengon zhvillimin e komunikacionit.

Gjatë punimeve për dëmtimet eventuale në infrastrukturë përgjigjet vet investitori.

Gjatë kryerjes së punimeve investuesi gjegjësisht kryesi i punimeve është i obliguar që të i përmbahet rregullave tekniko - ndërtimore të ndërtimit dhe pas përfundimit të punimeve **vendin ndërtimor ta kthejë në gjendjen e mëparshme gjegjësisht traseja të kthehet në gjendjen e mëparshme** - sipas nenit 34 dhe 35 të Vendimit të cekur më lartë.

Sipërfaqet të cilat janë të dëmtuara gjatë ekzekutimit të punimeve gjegjësisht gjatë ndërtimit duhet të kthehen në gjendjen e mëparshme, gjithashtu zonat e gjelbëruara të kultivohen me gjelbërim, kurse trotuarët dhe rrugët të kthehen në gjendjen e mëparshme (kubëza dhe asfalt - si për nga cilësia dhe trashësia njashtu edhe për nga materiali).

Obligohet investitori që materialin e panevojshëm ndërtimor dhe mbeturinat e tjera të krijuara gjatë punimeve ti transportoj në deponi.

Për mos kryerje të punimeve sipas këtij Pëlqimi, inspekcioni përkatës do të veproj sipas rregullave të parapara me ligj.

Ky Pëlqim pushon të vlej nëse punimet nuk fillojnë në afat prej 1 viti nga dita e lëshuarjes së të njëjtit. Vazhdimi i vlefshmërisë së këtij Pëlqimi mund të bëhet edhe për një vit tjetër nëse nuk është ndryshuar pjesa e planit zhvillimor në bazë të së cilit është lëshuar ky dokument.

Ar sy e t i m

Në bazë të kërkesës së **z. Ditjon Bajraktari** - drejtor i firmës "Pashtriku" Shpk. nga Bllaca, Komuna Suharekë, me 07 Nr.350-60743 të datës 19.09.2022, ky Organ përmes shërbimit të vetë teknik e pas shqyrtimit të parashtrësës dhe shtojcave ka konstatuar se: Kërkesa është e arsyeshme dhe se parashtruesit të kërkesës mundë të i jepet **LEJA NDËRTIMORE** përkatësisht **PËLQIMI** për kryerjen e punimeve të lartpërmendura duke e obliguar që ta kthejë në gjendjen e mëparshme trasen dhe ta **mirëmbajë në një afat prej gjashtëmuaj** nëse ka dëmtime në te.

Kërkesës i është bashkangjitur dëshmia mbi pagesën e rregullimit të tokës ndërtimore konform Rregullores mbi tarifën dhe ngarkesat 01Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015.

Kërkesës i është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën e Pëlqimit për kryerjen e punimeve ndërtimore konform Rregullores mbi tarifën dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8. paragrafi 8.3.2. në vlerë prej **50.00 euro**.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtit.


Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës :
Agron Bajraktari



Drejtori i Drejtorisë:
Visar Kuçi





Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Clinton nr.3
Prishtina 10000
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.3
Prishtina 10 000
Republic of Kosovo



Për: Ditjon Nisret Bajraktari
PASHTRIKU SH.P.K

KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA DISTRIBUCIJU I SNABEŽENJE ELEKTROENERGIJE
KEDS - SH. 7 - 12 - 2021
Nr. 12769 Dt. PRISHTINEA 1

Lënda: 2[XII]2021
Nr. RL: 387512
PËRMES ARRIVËS

Adresa: Fsh. Bllacë
Therandë

Prishtinë (Qendër)

PËLQIM ELEKTROENERGJETIK

A. KUSHTET ENERGETIKE

Veprimtaria: Gurëthyes (1 njësi)

Fuqia e instaluar e Transformatorit: $S_{inst} = 400 \text{ kVA}$
Fuqia maksimale e njëkohshme: $P_{mnj} = 341 \text{ kW}$ (sipas projektit elektrik)

B. KUSHTET TEKNIKE

- Furnizimi i trafostacionit të ri me energji elektrike të bëhet nga dalja 10(20) kV "Peqani me kod: 32000007" nga NS 110/35/10(20)kV "Theranda". Ekzekutimi i kyçjes së TS-it të ri të bëhet nga shtylla ekzistuese e betonit e cila paraprakisht duhet të zëvendësohet me shtyllë të re SHB 12/1600 (shih zgjidhjen teknike). Nga shtylla kyçëse e deri te trafostacioni i ri të realizohet linja e re 10(20) kV sipas standardeve teknike dhe sipas projektit elektrik të aprovuar paraprakisht nga Departamenti i Investimeve KEDS. Trafostacioni i ri TS 10(20)/0.4 kV duhet të jetë me fuqi instaluese $S_n=400 \text{ kVA}$ i tipit "Blindë Metalike ose Murosur" me të gjitha pajisjet adekuate për këtë tip të trafostacionit dhe i ndërtuar në vend të përshtatshëm me mundësi të qasjes së përhershme. Pjesa e tensionit të mesëm duhet të ketë (1+1+1) kthina 10(20) kV (hyrje, matje dhe trafofushë) dhe një hapësirë e lirë për vendosjen edhe të një kthine dalëse sipas nevojës. Kthina hyrëse, matëse dhe trafofusha duhet të jenë me ndarës të fuqisë me gas me sistemin mekanik dhe elektrik të mbylljes së dyerve. Pjesa e tensionit të ulët 0,4 kV të ketë ndërprerës automatik të fuqisë AS-630 A me mbrojtje nga mbingarkesa, dalje të mjaftueshme si dhe baterinë kompenzatorike me mundësi të ajrosjes. Kyçja e gurëthyesit të bëhet me dalje të posaçme nga trafostacioni i ri duke e shtrirë kabllon nëntokësore 1 kV deri te KSHE sipas projektit elektrik dhe të dimensionuar sipas fuqisë së angazhuar të gurëthyesit të cekur në PEE. Realizimi i punimeve dhe i kyçjes të bëhet sipas normave teknike. Projekti i realizimit të punimeve (pikës kyçëse, realizimi i linjës 10(20) kV, konstruktimi i TS-it të ri, realizimi i kabllor 1 kV, kyçja e gurëthyesit në anën 0.4 kV të TS-it të ri) duhet të aprovohet në Departamentin e Investimeve KEDS. Të gjitha pajisjet elektrike të vendosura në LP, TS dhe 0.4 kV duhet të jenë të reja dhe në përputhje me standardet IEC/ISO, njëkohësisht të gjitha pajisjet elektrike dhe projekti elektrik duhet të aprovohen nga departamenti i investimeve KEDS.
- Instalimi i objektit-kantierit, realizimi i tokëzimi mbrojtës dhe punues duhen të bëhet konform rregullave teknike.
- Matja e energjisë elektrike për gurëthyesin të realizohet në pjesën 10(20)kV në kthinën matëse 10(20) kV të TS-it të ri, sipas mënyrës indirekte me njehsor elektrik multifunksional, i lidhur përmes transformatorëve matës të tensionit dhe transformatorëve matës rrymorë komfor fuqisë së transformatorit sipas projektit elektrik paraprakisht të aprovuar në KEDS. Përçuesit rrymor nga TMRR deri në njehsor të përzgjidhen me 6(gjashtë) ngjyra/etiketa të ndryshme me seksion bakër 4mm² dhe të vendosen në gyp të veçantë. Përçuesit e tensionit deri në njehsor të përzgjidhen me tri ngjyra/etiketa të ndryshme me seksion 2.5mm² dhe të vendosen në gyp të veçantë. Njehsori elektrik të jetë i licencuar nga MTI të Republikës së Kosovës dhe i vendosur në kthinën matëse, në vend të përshtatshëm ku do të ketë qasje për lexim në çdo kohë.

Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A,
është kompani e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës numri i regjistrimit: 70606119

4. Për lëshimin e trafostacionit të ri në punë investitori është i obliguar që të posedojë këtë dokumentacion:

- Lejen e ndërtimit të objektit energjetik nga Institucionet përkatëse për pronat shoqërore, ndërkaq lejen e noterizuar nga pronarët e pronave private.
- Fletë-dëftesat mbi prejardhjen e materialeve
- Projektin për largpërçuesin i përpiluar në bazë të PEE me atestet përkatëse
- Projektin e Trafostacionit i përpiluar në bazë të PEE me atestet përkatëse
- Atestet e matjes së tokëzimit mbrojtës dhe punues
- Kërkesën zyrtare për pranimin teknik të objektit energjetik
- Procesin nga komisioni mbi pranimin teknik të TS-it
- Procesin nga pranimi teknik i linjës 10(20) kV.

5. Për çdo rritje të fuqisë elektrike në objekt, konsumatori është i obliguar që nga KEDS, Divizioni i Shpërndarjes të kërkojë pëlqim elektroenergjetik plotësues.

6. Nëse kushtet e paraqitura nuk realizohen brenda 180 ditësh, ky pëlqim është i pavlefshëm.

Vërejtje:

1. Projektet dhe realizimi i punëve të punohen nga kompania-organizata e licencuar për punë të këtilla.

2. Kyçjen e trafostacionit dhe LP në rrjetin 10(20) kV duhet ta kryejnë punëtorët e Divizionit të Shpërndarjes pasi të është kryer pranimi teknik i elementeve të Shpërndarjes.

3. Shpenzimet e përpilimit të dokumentacionit teknik, zgjidhjes së çështjeve pronësore-juridike dhe ndërtimit të LP 10(20) kV dhe TS 10(20)/04 kV i bartë investitori.

4. Gjatë eksploatimit të energjisë elektrike konsumatori duhet të mbajë faktorin e fuqisë $\cos\phi \geq 0.95$ duke montuar bateritë kompenzatorike.

5. Para fillimit të punëve, investitori është i obliguar të sjellë në Divizionin e Shpërndarjes regjistrin e punëtorëve që do të kryejnë punët bashkë me emrin e organizatës së licencuar si dhe regjistrat e automjeteve të angazhuar në kryerjen e punëve.

7. KEDS do të operoj me rrjetin e tensionit të mesëm – 10(20) kV të ndërtuar nga ana juaj, ndërsa prishjet e mundshme në këtë linjë do të riparohen nga ana e juaj nën kontrollin e KEDS.

8. KEDS e mban të drejtën për të bërë inspektime dhe në rast të ndonjë mospërputhje të kushteve të ndërmarrë masa të menjëhershme.

9. Investitori deklaron se ka kuptuar kushtet e pëlqimit. Investitori deklaron se do t'i përmbahet kushteve dhe se merr përgjegjësi për të gjitha devijimet nga këto kushte, përveçse në rastet kur përgjegjësia është e palës së tretë.

10. Investitori deklaron se është i vetëdijshëm për pasojat e shkeljes së pëlqimit dhe se pranon hapjen e procedurave në rast të shkeljes eventuale.

11. Në emër të fuqisë së njëkohshme të angazhuar në objekt, investitori është i obliguar që KEDS-it, Divizionit të Shpërndarjes, t'i paguaj shumën prej:

Për fuqi të angazhuar
Për shërbim të kyçjes
TVSH sipas ligjit

341 x 15.00 = 5,115.00
180.00
953.10
Total = 6,248.10 €

Me Respekt,
Inxhinier për LR

Per. [Signature]

Menaxher për SHK (KEDS)

Drejtor i Përkujdesit (KEDS)

[Signature]
Burim QERIM

[Signature]
Sabri TËRNAVA



Ekzemplar: 1X Palës; 1X Njesisë SHK; 1X Arkivit

| | |
|---|--|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE | |
| Nr. Llogar. Org./Instit. Org./Unit. Nr. i Fajllave Dokument. No. Pages | Nr. Llogar. Proj. Prot. Prot. No. Dated Date |
| S10 -03- | 4513-2/21 12.09.22 |
| PRISHTINË / A No. 1 | |



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
 Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

| | |
|------------------------|---|
| DATE/A: | 06.09.2022 |
| REFERENC-Ë: | 21/4513/MMPHI |
| PËR/ZA/TO: | "Pashtriku" SH.P.K. Bllacë Suharekë, për veprimtarinë: shfrytëzim i gurit gëlqeror në Bllacë Suharekë |
| CC: | Komisioni për Leje Mjedisore |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Servet Spahiu, Zëvendësues Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim për Leje Mjedisore |

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Pashtriku" SH.P.K. Bllacë Suharekë, me Nr. Prot. 21/4513/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkresë gjeni :

1. Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "Pashtriku" SH.P.K. Bllacë Suharekë, për shfrytëzim i gurit gëlqeror në Bllacë Suharekë; dhe
2. Shtojcën: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 21/4513/MMPHI

Datë: 06.09.2022

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Vendimit për Pëlqimit Mjedisore me nr. prot. 10/918/1-ZSP- 241/10, të lëshuar me dt. 17.06.2010, Vendimit për Transferit të Pëlqimit Mjedisore me nr. 19/346/1-ZSP/143/19, të lëshuar me dt. 21.03.2019, në emër të kompanisë "Seticommerc" Sh.p.k. Suharekë, si dhe Vendimit për Transferit të Pëlqimit Mjedisore, tani në emër të operatorit "Pashtriku" SH.P.K. Bllacë Suharekë, me nr. 21/393/ZSP//21, të lëshuar me dt. 24.02.2021, si dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore të dt. 05.09.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M


1. Operatorit "Pashtriku" SH.P.K. Bllacë Suharekë, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: shfrytëzim të gurit gëlqeror në ngastrat kadastrale: nr. P- 72116003- 04491-0, zona kadastrale, Bllacë Suharekë.

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku bëhet shfrytëzimi i gurit gëlqerorë;
- 2.3. Të i përmbahet kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqerorë sipas përshkrimit në aplikacion;

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; <https://mmphi.rks-gov.net/>



- 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- 2.5. Vazhdimisht të behët spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara të cilat shfrytëzohen për bartjen së rërës dhe zhavorrit;
- 2.6. Pas përfundimit të aktivitetit të behët rehabilitimi i terrenit sipas përshkrimit në aplikacion;
- 2.7. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Pashtriku" SH.P.K. Bllacë Suharekë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore, sipas Mendimit profesional të dt. 05.09.2022, konstatoi se Operatori për veprimtarinë: shfrytëzim të gurit gëlqeror në ngastrat kadastrale: nr. P- 72116003- 04491-0, zona kadastrale, Bllacë Suharekë, plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.


Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Servet Spahiu

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës së Suharekë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së



Kryetarit

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË



REPUBLIKA E SUHAREKËS

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E SUHAREKËS

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

17.04.2025

| MARRE NË DORËZIM-PRIMLJENO-RECEIVED | | | |
|-------------------------------------|-----------------|---------------------|----------------|
| Njësia org. Org. Unit | Numri Number | Shtojca Appendix | Vlera Value |
| 11 | 06 | 22502 | L |

| | |
|-----------------------|---|
| Nr-DATË/A: | 07Nr.192/350-16918 datë 16.04.2025 |
| REFERENC-Ë: | 07Nr.350-16918 datë 18.03.2025 |
| PËR/TO: | Z.Armend Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Pronësore – Juridike dhe Kadastër. Z.Bali Muharremaj, Zyra e Kryetarit |
| Kopje: | Pashtriku SH.P.K. me përfaqësues Ditjon Bajraktari |
| CC: | Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis |
| Nga: | Drejtor i Drejtorisë: Visar KUÇI |
| LËNDA/SUBJECT: | AKTPËRCJELLËS. |

I nderuar,

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis Komuna e Suharekës, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-16918 të datës 18.03.2025 nga Pashtriku SH.P.K. me përfaqësues Ditjon Bajraktari me anë të së cilës është kërkuar që të pajiset me marrëveshje për shfrytëzimin e pronës për parcelën P-72116003-04491-0 Zona Kadastrale Bllacë me sipërfaqe të parcelës 163,081.9m². Sqarim: Duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030, parcela në fjalë është me destinim Pyje – ZP, Gurëthyes – ZmS-1 dhe pjesërishtë infrastrukturë rrugore, gjithashtu pala ka një pëlqim nga komuna për vazhdimin me licensim.

Por duke pasur parasysh që ndryshimet e Ligjit për KPMM-së për plotësimin e dokumentacionit i kërkohet shfrytëzuesit i pronës së Kuvendit Komunal të pajiset me Marrëveshje Shfrytëzimi të pronës Komunale, komuna në bazë të destinimit për sipërfaqen e parcelës ~ 10733.56 (e matur në QGIS) që sipas Hartës Zonale të Komunës është e paraparë Gurëthyes – ZmS-1 ta jep në shfrytëzim për këtë destinim duke i ndjekur proceduar.

Meqenëse kërkesa në fjalë bie në kompetencë të drejtorisë suaj, kërkesën së bashku me të gjitha shkresat e lëndës ua dërgojmë në kompetencë për shqyrtim dhe procedim të mëtutjeshëm.


Shtojcë: Lënda komplet

I dorëzohet: DSHPJK, Zyres së Kryetarit, dosje të DUPM-së.

SKICE IDEORE

Z.K.BLLACĚ
Komuna SUHAREKE

P=1:750



18.04.2025

SKICE IDEORE

Z.K.BLLACË
Komuna SUHAREKE

P=1:750



18.04.2025